



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site:www.klsh.org.al

Nr.389/5,Prot.

Tiranë, më 10.10.2019

V E N D I M

Nr. 123, Datë 10.10.2019

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË ME
OBJEKT "MBI PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT BRENDSHËM
FINANCIAR PUBLIK "

(Për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018)

Nga auditimi i ushtruar në "Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik", (këtu e në vazhdim shkurt DH/KBFP), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me objekt: "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë dhe dhënien e opinionit në të aktivitetit", për periudhën e audituar 01.01.2018-31.12.2018, u konstatua se megjithë përpjekjet dhe punën e bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik, mbetet ende një sfidë rritja e eficensës së këtyre strukturave dhe sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në tërësi.

Pavarësisht punës, përmirësimeve të bëra dhe masave të marra gjatë vitit 2018, u konstatua se, DH/AB, nuk ka luajtur plotësisht rolin e saj si harmonizuese e metodologjive dhe monitoruese e sistemeve KBFP, nuk ka administruar plotësisht procesin e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të veprimtarisë së njërive të auditimit të brendshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuar të auditimit të brendshëm publik, duke mos bërë të mundur monitorimin e plotë të veprimtarisë audituese në nivel kombëtar, problematika të përsëritura këto edhe në auditimet e mëparshme të KLSH. Nuk janë marrë masa dhe nuk janë zbatuar 12 rekomandime organizative, nga 24 rekomandime të lëna nga KLSH në auditimin e fundit, duke mos pranuar veçanërisht 2 rekomandime për përmirësime ligjore me impakt në sistemet e kontrollit.

Pasi unjoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit,shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Kontrollit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm,në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

VENDOSA:

I.Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë dhe dhënien e opinionit* në “Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik”,për periudhën e audituar 01.01.2018- 31.12.2018, sipas programit të auditimit nr. 389/2, datë 05.06.2019 miratuar nga Kryetari i KLSH, i ndryshuar me njoftimin nr. 238/2, datë 14.08.2019.

II. Të miratoj Opinionin e Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik e cila përfshin aktivitetin e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI).Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Opinionin e Grupit të Auditimit mbi përputhshmërinë.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse,si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, përgjatë proceseve të ushtrimit të përgjegjësive në përmbushje të misionit të saj, harmonizues, monitorues dhe raportues, jo në të gjitha rastet i ka kryer ato në përputhje me ligjin nr.114/2015 datë. 15.10.2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin e Auditit të Brendshëm, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre. Nga auditimi rezulton se ka deviacione të cilat vijnë edhe si mungesëe një kuadri të plotë ligjor në përmbushje të kërkesave të ligjit.Ky konkluzion justifikon dhënien e një Opinionit të Kundërt¹ mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2018.

¹ ISSAI 4000 Opinionin negativ (i kundërt)

Objekivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Përgjegjësitë e drejtuesve të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, ndër të cilat përmenden: ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ligji nr. 114/2015 datë 15.10.2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, dhe përgatitja e Raportit Vjetor lidhur me nivelin e AB dhe shtrirjes së MFK në shkallë kombëtar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme dhe dhënien e opinionit nëse aktiviteti i Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik është kryer në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

B.MASA ORGANIZATIVE:

B.1.Gjetje e Rekomandime (12), për Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB)

(Trajtuar më hollësisht në Aneksin nr. 1, pjesë e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të paraqitura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë rezulton se janë krijuar 10 Komitete Auditimi (KA). Pavarësisht numrit të ulët të KA-ve, rezulton se nuk ka informacion mbi aktivitetin e këtyre Komiteteve e parashikuar si një hallkë që do të garantonte pavarësinë e strukturës së auditit të brendshëm, problematikë kjo e trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH, rekomandim i cilin nuk është pranuar nga DH/AB. Kjo jo në përputhje me kërkesat e nenit 13, pika 2 të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, është përcaktuar se: “*Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë*” dhe në pikën 3 është përcaktuar se: “*Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrisë të Financave*”, pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr. 114/2015, Këshilli i

Ministrave ka miratuar VKM nr.160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komiteteve të Auditit të Brendshëm një njësitë publike”, ku janë përcaktuar roli dhe autoriteti i Komitetit të AB, përbërja dhe funksionimi, si dhe kompetencat dhe raportimi. Konstatohet se, as në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 dhe as në VKM nr. 160, datë 02.03.2016, nuk janë përcaktuar kritere të qarta dhe të matshme për krijimin e Komiteteve të Auditimit, duke e lënë këtë vendimarrje në vullnetin e titullarëve të institucioneve.

Gjithashtu, në pikën 3, të kreut të III-të këtij Vendimi, ku janë përcaktuar kompetencat dhe raportimi i Komitetit të Auditimit është cilësuar se: “Komiteti i Auditimit të Brendshëm duhet të përgatisë, në fund të çdo viti, një raport përmbledhës për titullarin e njësisë publike, për veprimtarinë vjetore të komitetit”, nuk shprehet qartëdetyrimi i KA-ve për raportim periodik pranë DH/AB. Për të tretin vit rradhazi KLSH, ka kërkuar forcimin e rolit që Drejtoria e Harmonizimit duhet të ketë me qëllim garantimin e krijimit dhe funksionimin e këtyre strukturave si udhëheqëse dhe monitoruese e sistemit të auditit të brendshëm, pjesë integrale e së cilit janë edhe këto Komitete. Gjatë periudhës objekt auditimi është kërkuar informacion mbi numrin e komiteteve të auditimit të krijuara, dhe përgjigjja e subjektit ka qenë se **nuk e përmban këtë përgjegjësi në detyrat e saj funksionale.**

Sjellim në vëmendje se raporti i auditimit final² i përfaqësuesve të Komisionit Europian “Ad hoc Audit on Internal Audit Capacities in Albania in the context of Internal Control Frame ëork under the instrument for Pre-Accession II (IPA II)”²ka cilësuar se “Raportet e auditimit të brendshëm i raportohen direkt Ministrave, dhe jo Komiteteve të Auditimit, dhe si rezultat ekziston një risk potencial për mos garantimin e pavarësisë së këtyre strukturave”, duke rekomanduar se njësitë e Auditimit të Brendshëm duhet të raportojnë planet dhe rezultatet e veprimtarisë (raporte auditimi dhe raporte vjetore), tek Komiteti i Auditimit (në ato njësi ku ky organ është krijuar), para dërgimit tek Titullari i njësisë publike, kjo për të arritur pavarësinë e plotë të audituesve nga titullari dhe menaxhimi i lartë. Në planin e veprimit të DH/AB për këtë raport në ndryshim nga qëndrimi në rastin e rekomandimit të lënë nga KLSH, është përcaktuar se kjo do të ndiqet në të gjitha njësitë publike, bashkitë, ministritë, etj,megjithatë është konstatuar se numri i njësive që kanë krijuar komitete, nuk është përfaqësues për të minimizuar riskun e konstatuar për pavarësinë e njësive të AB.

1.1 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë, të marrë masat për përfshirjen në detyrat funksionale të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, sigurimin e informacionit për krijimin dhe funksionimin e Komiteteve të auditimit pranë njësive publike dhe monitorimi i veprimtarive respektive, me synim garantimin e pavarësisë së strukturave të AB.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi:Drejtorja e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, në vijim edhe të rekomandimeve të lëna nga auditimi i përfaqësuesve të Komisionit Europian, të marrë masat për të përcjellë pranë Komiteteve të Auditimit, detyrimin për të kërkuar informacion nga njësitë e auditit të brendshëm në strukturat ku janë ngritur këto njësi, dhe varësitë respektive, mbi gjetjet dhe rekomandimet e konstatuara në raporte, përpara dërgimit të tyre tek titullari i njësive, me qëllim sigurimin e pavarësisë së veprimtarisë së auditit të brendshëm.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi për organizimin dhe funksionimin e DH/AB, konstatohet se, sikundër është trajtuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH-së,DH/AB nuk ka të dhëna

²Shkresë Ref. Ares (2019)2176517 datë 27/03/2019

të sakta lidhur me mbulimin me auditim për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme me qëllim që të përcaktohen kapacitetet audituese dhe nevojat për mbulim me auditim në shkallë sistemi me njëri nga format e përcaktuara në nenin 10 “Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm” të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar me VKM nr. 353, datë 11.05.2016, pikat 1 dhe 7, ku përcaktohet se: “Njësitë publike brenda 6 muajve nga data e hyrjes së fuqi të këtij vendimi, të kryejnë organizimin e brendshëm për njësinë e auditimit të brendshëm”.Për këtë çështje, në raportin vjetor të gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk rezultojnë të ketënjë analizë të plotë në shkallë sistemi nga ana e DH/AB për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njërive të auditimit të brendshëm në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që kjo njësi të jap ndihmesën e saj për ngritjen, funksionimin dhe konsolidimin e njërive të auditimit të brendshëm në shkallë vendi.

2.1 Rekomandimi: DH/AB të marrë masat në mënyrë të menjëhershme për kryerjen e një analize me qëllim identifikimin e nevojave për mbulim me auditim të brendshëm në rang kombëtar dhe përcjelljen e këtij informacioni pranë Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, duke mos kryer një raportim të sistemeve të KBFP vetëm bazuar në të dhënat e njërive që kanë raportuar pranë kësaj drejtorie.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për vitin 2018, në 77 institucione (nga 127 njësitë që raportojnë) ose rreth 60% e strukturave të auditit të brendshëm në sektorin publik veprojnë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pra si rezultat nuk garantojnë kontrollin e brendshëm të cilësisë. Më konkretisht, në këto njësi nuk plotësojnë kriteret e përcaktuar në ligjin e AB, të tilla si njësi me më pak se 3 auditues, në kundërshtim me pikën 3, të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se: “Njësia e AB përbëhet nga jo më pak se tre punonjës përfshirë dhe drejtuesin e njësive”. Në strukturën e njësive të auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik; si dhe nuk plotësohet kriteri i raportit 1/3 e audituesve të pacertifikuar të lejuar. Gjithashtu, sipas raporteve të dërguara nga njësitë e auditit të brendshëm pranë DH/AB rezultojnë 138 auditues ose rreth 32% e audituesve janë me eksperiencë më pak se 3 vite si auditues i brendshëm si dhe 34 drejtues të njësive AB që nuk plotësojnë kriterin e 5 viteve eksperiencë pune në auditin e brendshëm), kjo në kundërshtim me nenin 11 pika 2, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

3.1 Rekomandimi: DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të përcjelljë në mënyrë sistematike pranë Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, krijimin dhe plotësimin e njësive të auditimit të brendshëm publik, me numrin dhe eksperiencën e audituesve, në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohen tregues mjaft të dobët të performancës të aktivitetit të njësive të Auditit të Brendshëm. Kështu, rezultojnë 8 institucione me 0 angazhime auditimi për vitin 2018, 10 institucione kanë planifikim 0 të numrit të auditimeve për vitin 2018 ndërsa në 44 institucione kemi një raport 0-2.5 auditime të kryera për çdo auditues përgjatë gjithë vitit 2018, ngarkesë kjo mesatarisht 6 muaj për të realizuar një mision auditimi.

Nga auditimi i 65 njësi publike të përzgjedhura u konstatua, nivel tepër i ulët i numrit të gjetjeve si në rastin e 28 institucioneve të cilat kanë raportuar 0-10 gjetje gjatë gjithë vitit 2018. Një tregues ky i performancës së dobët të njësisve të AB dhe angazhime formale auditimi, ndërkohë që nga auditimet e KLSH-së, në po të njëjtat njësi ekonomike, rezultojnë numër shumë më i lartë gjetjesh të problematikave me impakt negativ në mirëqeverisjen e këtyre njësisve dhe fondeve që ato shpenzojnë. I njëjti arsyetim, vlen edhe për vlerat e dëmit të raportuar nga puna e këtyre strukturave për sa kohë që vlera e dëmit të konstatuar për 58 institucione është nga 0-100,000 lekë. Evidenca të hollësishme janë paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit për qëllime të analizës dhe deviacioneve midis gjetjeve të strukturave AB dhe të audituesve të KLSH, punë që duhet të ishte bërë nga kjo strukturë për të nxjerrë dhe analizuar faktorët performances të ulët të AB-ve.

4.1 Rekomandimi: DH/AB në mënyrë të menjëhershme duhet të analizojë çështjen e cilësisë së punës së njësisve AB (eficencën e tyre) dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e saj në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP. Është e rëndësishme që aktiviteti i auditimit të brendshëm të marrë reagime nga palët kyçe të interesit dhe ti përcjellë tek të gjitha njësitë e AB dhe jo vetëm tek ato njësi që kanë qenë pjesë e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

DH/AB në rolin e saj si harmonizuese e metodologjive dhe monitoruese e sistemeve KBFP ku një nga shtyllat është AB, duhet menjëherë të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të performancës së sektorit publik për komponentin AB, për të vendosur edhe elemente e tregues të tjerë (indikatore) me qëllimvlerësimin, matjen sasiore dhe cilësore të punës së këtyre strukturave.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i të dhënave për kampionin e përzgjedhur për 65 institucioneve publike, u konstatuan se gjatë vitit 2018, kanë hyrë në strukturat e audituesit të brendshëm 107 auditues të rinj dhe janë larguar 74 auditues ku konstatohen 16 institucione të cilat kanë shtuar strukturën e AB me 1 ose 2 persona, dhe vetëm 2 institucione të cilat kanë reduktuar strukturën e AB me 1 apo 2 punonjës të AB. Nëse i referohemi plotësisht të strukturave në krahasim me një vit më parë, rezultojnë se 15 institucione rezultojnë me 1 ose 2 punonjës të AB më shumë se plani i derguar, Bashkia Lezhë me 4 punonjës më shumë se një vit më parë e cila nuk i justifikon dhe ngarkon me punë gjatë gjithë vitit; dhe 8 institucione më 1 apo 2 punonjës të AB më pak në strukturën e AB.

Në shkallë kombëtare, sipas evidencave të vëna në dispozicion nga DH/AB, rezultojnë se me rritjen e numrit të njësisve AB të ngritura, niveli i audituesve të certifikuar në sistem (pra që punojnë si auditues të brendshëm) ka rënë nga 90% (në vitin 2015) në 77% në (në vitin 2018), ndërkohë që në proces certifikimi janë mbi 30 auditues të punësuar. KLSH, në vite ka sjellim në vëmendje se numri i audituesve të **brendshëm të certifikuar në vite është tepër i lartë.**

Jashtë sektorit publik janë aktualisht rreth 1630 auditues të certifikuar³ (1960⁴ auditues të certifikuar nga të cilët vetëm 330 të punësuar në sektorin publik). Kjo flet për një politikë jo të kujdesshme të punësimeve në strukturat e AB, emërimet dhe largimet të vazhdueshme pa paragjykuar arsënyen, kanë sjellë struktura në lëvizje, jo të konsoliduara dhe ajo që është më e rëndësishmja profesionalizëm jo në cilësinë e kërkuar për këto struktura të rëndësishme për forcimin e sistemeve të kontrollit në institucionet publike. Nga ana tjetër tregon se misioni kryesor i DH/AB vijon të mbetet procesi i certifikimit megjithë përpjekjeve për trajnimin e vijueshmë të AB të certifikuar (ku një pjesë e tyre janë edhe formale dhe pa efektivitet dhe madje me kosto në kohë). Ndryshimet strukturore dhe lëvizjet e shpeshta të stafit të AB që sjellin jo vetëm paqëndrueshmëri të strukturave por ndikojnë edhe në nivelin e rezultateve që kanë këto struktura në mbështetje të drejtimit për mirëfunksionim të institucioneve dhe

³30 auditues më shumë se 1 vit më parë

⁴Sipas rregjistrimit të Audituesve të Certifikuar të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

minimizimin e paligjshmërive/parregullsive me efekte negative në përmbushje të objektivave afatshkurtër dhe afatmesëm.

5.1 Rekomandimi: DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të përcjellje në mënyrë sistematike të lëvizjeve pranë Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, sidomos për hyrjet apo daljet të cilat bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke rekomanduar edhe masa të nevojshme për përmirësimin e mënyrës së kryerjes së trajnimeve, përzgjedhjes së lektorëve dhe tematikave të trajtuara, duke bërë edhe publikimet në faqen zyrtare të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në vijim të detyrimit të njësive për të dërguar planet strategjike dhe vjetore, për dërgimin e tyre jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, nga 90 subjekte të përzgjedhura 19 ose 21% e tyre, nuk kanë zbatuar afatin e dërgimit të këtyre dokumenteve zyrtar. Në lidhje me hartimin e planeve strategjike dhe vjetore, u konstatuan se nërreth 34 njësi struktura e planit nuk ishte në përputhje me diagramën e Planit Strategjik dhe Vjetor në manualin e auditimit të brendshëm.

Në përgjithësi konstatohet një ulje në numrin e auditimeve të planifikuara për tu realizuar nga njësitë publike në krahasim me numrin e tyre gjatë 3 viteve të fundit. Kështu nga 120 njësitë që kanë dërguar planin e auditimeve për vitin 2018, kanë planifikuar fillimisht 1302 auditime në total, në planifikimin e ndryshuar janë raportuar 127 subjekte me 1247 auditime, nga të cilat janë realizuar 1232 auditime. Këtu veçojmë institucionin e AKSHI-t, i cili pavarësisht se ka kryer certifikimin e audituesve të brendshëm pranë DH/AB, nuk ka kryer raportimin për veprimtarinë e aktivitetit, planin fillestar dhe atë të ndryshuar. Gjithashtu, në vijim të rekomandimit të DH/AB për planifikimin e auditimeve të veçanta për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi i planeve të dërguara nga njësive publike rezultojnë 45 njësi që nuk e kanë përfshirë këtë lloj auditimi, si një auditim të veçantë edhe pse kryerja e auditimeve për zbatimin e rekomandimeve është një rekomandim i KLSH i papranuar.

Në lidhje me ndryshimet në planet vjetore, rezultojnë të jenë kryer në total vetëm 22 ndryshime në planet respektive të njësive publike, të shoqëruar meshkresa për ndryshim planesh drejtuar DH/AB, pavarësisht devijimeve më të shumta në numër të raportuara në planin fillestar të auditimeve të këtyre strukturave. Për sa i përket realizimit të planit, bazuar në të dhënat e konsoliduara të marra nga ana e DH/AB, rezulton se në 44 raste u konstatua mosrealizim të planeve fillestare të auditimit, ndërsa në 114 raste u konstatuan me tejkalim të tij. Sa sipër nga DH/AB nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” neni 24 shkronja (ç) ku parashikohet se: DH/AB, përgatit dhe administron planin e konsoliduar strategjik e vjetorë së auditit të brendshëm në njësitë publike.

6.1 Rekomandimi: DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj të përcaktuara në shkronjën (ç) të nenit 24 të LAB, të marrë masat për konsolidimin e mangësive të konstatuara në përmbajtjen, afatin e dërgimit, llojin e auditimeve të planifikuara, dhe mënyrat e rishikimit të këtyre planeve, duke përfshirë këtë problematikë në raportimin vjetor. Ndërkohë në rastet e evidentimit të mospërputhjes së dokumentacioneve të dërguara nga njësitë me specifikimet e Manualit të AB të për mos përmbushje detyre funksionale, ndaj personave përgjegjës të kërkojë nga Titullarët marrjen e masave disiplinore.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në bazë të rezultateve të deklaruara në auditimet e kryera përgjatë vitit 2018, për 127 njësitë e auditimit janë konstatuar gjithsesi 9,368

gjetje dhe një dëm ekonomik në vlerën totale prej **4,332 milion lekë** ose 3,516 milion lekë më pak krahasuar se një vit më parë. Në vlerën totale të dëmit ekonomik, 65% ose 2,806 milion lekë i përket gjetjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në fushën e prokurimit. Vlera e gjetjeve dhe dëmi ekonomik për periudhën 2012-2018 paraqiten si më poshtë:

Tabela, vlera e dëmit në nivel total për një periudhë 7 vjeçare, shprehur në 000/lekë me MIE

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789.045	2.111.308	7.848.500	4.332.463
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286	9.368
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400	429

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar grupi i auditimit

Tabela, vlera e dëmit në nivel total për një periudhë 7 vjeçare, shprehur në 000/lekë pa MIE.

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Totali (në vlerë)	3.199.964	4.321.991	20.138.457	68.789.045	2.111.308	1.819.500	1.526.267
Totali (në numër)	4.698	3.556	4.441	4.186	9.421	6.286	9.368
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400	429

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar grupi i auditimit

7.1 Rekomandimi: DH/AB të bëjë një analizë të drejtë dhe të plotë të nivelit të gjetjeve në raport me shtrirjen e strukturës AB në sektorin publik, llojeve të gjetjeve dhe në reflektim të rekomandimeve të KLSH-së, si auditues i jashtëm, dhe të raportojë në vazhdimësi pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nivelin e strukturave AB dhe efikasitetin e punës së tyre. Plotësia dhe saktësia e raportimit mbi këtë sistem është jo vetëm obligim ligjor por edhe përgjegjshmëri ndaj funksioneve që kryhen.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se në vijim edhe të rekomandimeve të mëparshme të KLSH, në Manualin e Auditimit të Brendshëm, nuk është përcaktuar qartë çështja e statusit të zbatimit të rekomandimeve dhe as mënyra e ndjekjes dhe raportimit të tyre, të cilat janë tregues thelbësor, të performancës, efikasitetit dhe përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik. Mosndjekja dhe raportimi në vazhdimësi i rekomandimeve, zbeh rolin e auditimit të brendshëm dhe nuk i shërben titullarit të institucionit për vendimarrje me qëllim në arritjen e objektivave të njësisë. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve është edhe një nga kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, respektivisht:

- *nenit 6*, “Roli i auditimit të brendshëm”, shkronja “ç”, ku përcaktohet: duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna”

- *nenit 14*, “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm” shkronja “iv”, ku përcaktohet, “iv) veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;”

- *nenit 24* “Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm”, shkronja “ë”, ku përcaktohet se: “ë) analizon rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njësisë të auditimit të brendshëm”.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se në Manualin e Auditimit, konkretisht në formularin nr. 4, ndonëse pasqyrohen të dhënat për rekomandimet **por nuk pasqyrohen të dhënat për rekomandimet e papranuara dhe arsyet e mos pranimit të tyre.**

Kështu në pasqyrën nr. 5 “Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin” që shoqëron raportin vjetor të NJAB-ve në raportimin për statusin e rekomandimeve të lëna, nuk pasqyrohen nga njësitë e auditimit të brendshëm, **rekomandimet e pa zbatuara**, dhe si rezultat këto rekomandime raportohen nga njësitë dhe njëkohësisht DH/AB në raportin vjetor si rekomandime në proces zbatimi duke mos identifikuar saktë situatën reale të zbatimit të tyre.

Nga auditimi i dias praktikave (dosjeve) u konstatua se, pjesa më e madhe e njësive publike në totalin e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak nuk janë hedhur fare ose janë të pasakta. Gjykojmë të nevojshme se përmirësimi i pasqyrave statistikore me të gjithë treguesit e nevojshëm do t'u shërbejnë më mirë titullarëve të njësive publike për përmirësimin e veprimtarisë dhe rritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria DH/AB të marrë masat për rishikimin e të dhënave statistikore konkretisht të pasqyrës së raportimit të shkallës së zbatimit të rekomandimeve në manualin e auditit të brendshëm, në mënyrë që të kryhet saktë raportimi i situatës nga njësitë e auditit të brendshëm duke identifikuar **gjetjet e pazbatuara nga ato në proces zbatimi** si dhe të saktësohen të dhënat e Raportit Vjetor të raportuar pranë Ministrisë dhe Kryeministrit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Një prej objektivave të Drejtorisë Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm është edhe kryerja prej 25 vlerësime të jashtme të cilësisë çdo vit. Nga auditimi konstatohet se kjo Drejtori nuk disponon të dhëna historike (database) të vlerësimeve të jashtme të njësive AB të kryera nga kjo Drejtori ndër vite. Për pasojë përzgjedhja e njësive gjatë planifikimit të aktivitetit të Drejtorisë për vitin në vazhdim në lidhje me vlerësimin e jashtëm nuk bëhet në bazë të frekuencës apo riskut të vlerësuar në përputhje me Manualin përkatës. Gjithashtu, regjistri i Vlerësimeve të Jashtme të Njësive të Auditimit të Brendshëm, nuk disponon të dhëna lidhur me vlerësimet e jashtme të kryera nga KLSH-ja, apo vlerësues të kualifikuar të pavarur jashtë njësisë.

9.1 Rekomandimi: DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB të studiojë me përgjegjësi kapacitetet audituese që ka për mbulimin e detyrave funksionale që rrjedhin nga neni 24 i LAB dhe t'i propozojë Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë gjetjen e rrugëve efektive për realizimin e objektivit prej 25 vlerësime të jashtme të cilësisë çdo vit.

9.2 Rekomandimi: DH/AB të marrë masat për kryerjen e përzgjedhjes së njësive publike në të cilat do të kryhet vlerësimi i jashtëm i cilësisë, në përputhje me kërkesat e Manualit të AB, si dhe duke patur parasysh diferencat e mëdha të gjetjeve midis strukturave AB dhe auditimeve të KLSH.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Kriteret e kualifikimit të audituesve të brendshëm publik janë rregulluar në kapitullin e VI-të Ligjit të AB, ku në nenin 19, pika 2, përcaktohet se, të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë të gjithë individët e klasifikuar në shkronjën “ç” të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, pra punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Gjatë kësaj periudhe ai duhet të pajiset me certifikatën e audituesit të brendshëm, ndryshe ndërprehet marrëdhëniet e punës.

Nga auditimi u konstatua se, në nenin 23 të rregullores nr.37, datë 10.03.2016, është përcaktuar se: *“Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e certifikimit dorëzohen dhe ruhen në protokollin e Ministrisë së Financave në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 muaj nga data e dhënies së provimit/riprovimit. Asgjësimi i tyre bëhet nga një komision prej tre anëtarësh, të caktuar me urdhër nga struktura përgjegjëse për kualifikimin në përbërje të të cilit janë dy punonjës të strukturës përkatëse për kualifikimin dhe një punonjës i strukturës përgjegjëse për shërbimet në Ministrinë e Financave. Deri në asgjësimin e tyre, fletoret administrohen nga struktura përgjegjëse për kualifikimin”.* Në vijim të këtij përcaktimi, në

auditimin e mëparshëm të KLSH është kërkuar interpretim pranë drejtorisë së arkivave, dhe sipas përgjigjes të shkresës nr.8766/1, prot datë 25.09.2018 është sygjëruar se afati i ruajtjes të jetë jo më shumë se 6 muaj nga data e dhënies së provimit, sepse sipas Normave tekniko-profesionale, brenda 6 mujorit të parë të vitit pasardhës, sekretaria mbyll dosjet e hapura sipas pasqyrës emërtuese të çeljes së tyre dhe bën dorëzimin në arkiv. Si rezultat, konfirmuar edhe nga përgjigja e drejtorisë së arkivave, afati i ruajtjes prej 3 muajsh është pak krahasuar me përcaktimet e normave tekniko-profesionale. Nga ana tjetër një afat i tillë kohor e bën të pamundur auditimin e këtij procesi të rëndësishëm.

10.1 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e përgjegjësit për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së AB të shfuqizojë nenin 23 të rregullores nr. 37, datë 10.03.2016 i cili specifikon se “Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e certifikimit dorëzohen dhe ruhen në protokollin e Ministrisë së Financave në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 muaj nga data e dhënies së provimit/riprovimit si dhe të urdhërojë veçimin dhe asgjësimin e dokumentacionit të përkohshëm në përputhje me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, dhe vetëm pas një kontrolli/auditimi nga një strukturë e brendshme apo dhe e jashtme auditimi për të marrë siguri për këtë proces të rëndësishëm.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e trajnimit të vijueshëm nuk parashikon rastet e dorëheqjes së trajnerëve dhe mënyrat se si do të vijohet me përzgjedhjen e trajnerit zëvendësues. Si rezultat, në këto raste nuk është përcaktuar në kuadrin rregullativ, përzgjedhja e trajnerit zëvendësues.

11.1 Rekomandimi: DH/AB në bashkëpunim me KKAB të marrë masat për rishikimin e rregullores së trajnimit të vijueshëm profesional, me qëllim përfshirjen e procedurave që do të ndiqen rastet e dorëheqjes së trajnerëve gjatë implementimit të programit vjetor të trajnimit të vijueshëm.

Menjëhere

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se “Certifikata e lëshuar nga Center for Financial Reporting Reform (CFRR) W B. G., nuk është certifikatë profesionale e fushës së auditimit të brendshëm, dhe aq më pak e njohur ndërkombëtarisht, duke mos plotësuar kushtin e parë të kërkuar nga ligji “*Individët që zotërojnë një certifikatë profesionale të njohur ndërkombëtarisht në fushën e auditimit të brendshëm*”.

Referuar kërkesave të Neni 9, të RregulloresTrajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, ...“*Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin e AB në sektorin publik sic) Të jetë i punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik...*”

“Njohja e certifikatës profesionale ndërkombëtare” për dy punonjës të Stafit në strukturën e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, respektivisht:

Znj.K. H., Drejtor i Përgjithshme i Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në MFE.

z.D. F., Drejtori i Drejtorisë Harmonizimit MFK, në MFE.

“Njohja e certifikatës profesionale ndërkombëtare” është bërë kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi si më poshtë:

Së pari: Dy punonjësit e certifikuar nuk janë të punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, në kundërshtim me kërkesat e RregulloresTrajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 të

Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, neni 1 “Kriteret dhe procedurat e regjistrimit të kandidatëve”, pika 2 përcakton se: “ Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin e AB në sektorin publik si më poshtë:

a) Të kenë diplome universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet; b) Të kenë përvojë pune 3 vjet në profesion; c) Të jetë i punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik...

Së dyti: Dy punonjësit e certifikuar, nuk janë të punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm publik, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe konkretisht, neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” ku parashikohet se: 1. Certifikimi i audituesve të brendshëm organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB, sipas procedurës së miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. 2. Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë individët e klasifikuar në shkronjën “ç”, të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji. 3. Individët, që zotërojnë një certifikatë profesionale, të njohur ndërkombëtarisht, në fushën e auditimit të brendshëm, i nënshtrohen një procedure specifike certifikimi, të përcaktuar në urdhrin e nxjerrë sipas pikës 1 të këtij neni.

Së treti: Dy punonjësit e certifikuar, nuk janë të pajisur me certifikatën si “Auditues i brendshëm”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” konkretisht neni 11, pika 2, shkronja “ç”, ku parashikohet se:

ç) punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t’i nënshtrohet detyrimit të procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm”. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm”, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.

Së katërti: Dy punonjësit e certifikuar, nuk kanë të dokumentuara dhe nuk i janë nënshtrohur programeve dhe kurseve profesionale të kryera jashtë vendit në fushën e auditit të brendshëm, dhe programet/modulet e trajnimit, koha e studimit, si dhe kualifikimet, nuk janë përcaktuara nga kuadri ligjor i vendit të origjinës, krahasuar me kuadrin ligjor dhe nënligjor shqiptar. Pra sa sipër nuk janë zbatuar kërkesat e Rregullores së Trajnimit të Vjeshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave, konkretisht neni 21 “Procedura e njohjes së Certifikatës Profesionale Ndërkombëtare” Nisur nga vlerësimi i dokumentacioneve të vendosura në dispozicion për 2 aplikantët të cilët kanë kryer ndjekjen e këtyre trajnimeve, nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuar në ligj, referuar jo vetëm llojit të certifikatës e cila po njehsohet, por edhe llojit të programeve/moduleve të kryera nga aplikantët sipas dokumentacioneve janë dorëzuar certifikata pjesëmarrjeje në workshopet 4 ditore dhe 2 workshopet virtuale 2-orëshe, të cilët nuk rezultojnë të përfshijnë kryerjen e provimeve për vlerësimin e njohurive, sikundër parashikon programi i certifikimit të audituesve të ligjit shqiptar.

Programi i Certifikimit të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2017-2018, është organizuar sipas 6 moduleve, me 46 tema dhe për secilin modul edhe një testim Programi sipas këtyre moduleve është parashikuar të zhvillohet në 84 orë mësimore dhe kohëzgjatja normale e orës mësimore do të jetë 60 minuta. Ngarkesa mesatare mujore në auditor, për leksione dhe ushtrime praktike është në intervalin 12-24 orë për çdo modul, me frekuentim nga 2 deri në 4 seanca, të përfshira në kalendarin e trajnimit dhe miratuar nga Komisioni i Kualifikimit.

Ndërkohë temat e trajtuara në modulet e frekuentuara nga aplikantët vetëm duke i listuar pa hyrë në përmbajtjen e secilës, rezultojnë 26 tema të zhvilluara nga 46 tema të cilat mbulojnë Modulet e miratuara nga vetë Komisioni i Kualifikimit.

Ajo që konkludohet është se nga ana e Komisionit të Kualifikimit, nuk është bërë vlerësimi i drejtë dhe në përputhje me kuadrin rregullativ në fuqi jo vetëm referuar llojit të certifikatës, por edhe faktit të krahasimit të orëve të ndjekura/provimeve të dhëna si dhe të temave të mbuluara referuar materialit të depozituar, megjithatë gjejmë të shprehur nga komisioni se trajnimi i bërë nga aplikantët është në përputhje me sa kërkohet nga ky komision në rastin e certifikimit të Audituesve të Brendshëm Publik.

Pra sa sipër nuk janë zbatuar kërkesat e Rregullores së Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrin nr. 3, datë 08.01.2016 të Ministrisë të Financave, konkretisht neni 21 “Procedura e njohjes së Certifikatës Profesionale Ndërkombëtare”, ku parashikohetse:

1) Njohja zyrtare e certifikatës profesionale në fushën e auditimit të brendshëm, bazohet në parimin e ngjashmërisë së programeve/moduleve profesionale të trajnimit të kryer nga aplikantët jashtë vendit në masën 75%, me programin/modulet e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, të miratuar nga Komisioni.

2) Baza e vlerësimit të programeve dhe kurseve profesionale të kryera jashtë vendit në fushën e auditimit të brendshëm janë programet/modulet e trajnimit, koha e studimit, si dhe kualifikimet që përcaktohen nga kuadri ligjor i vendit të origjinës, krahasuar me kuadrin ligjor dhe nënligjor shqiptar.

3) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi, me bashkëpunim me Komisionin, ndjek procedurat e njohjes së certifikatave profesionale ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm të individëve që i zotërojnë ato, sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Individët që zotërojnë një certifikatë profesionale të njohur ndërkombëtarisht në fushën e auditimit të brendshëm, dorëzojnë dosjen e aplikimit për njohje pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e brendshëm

b) Dosja e aplikantit duhet të dorëzojë këto elementë:

i. Kërkesë me shkrim për aplikim;

ii. Certifikatën e kualifikimit profesional të marrë jashtë vendit;

iii. Listën e programeve/moduleve të mbrojtura dhe kreditet e marra ;

iv. Dokument identifikimi.

4) Dokumentet e përcaktuara në pikën ii) dhe iii) të germës b) të këtij neni, duhet të jenë origjinale ose fotokopje e noterizuar, si dhe të jenë të legalizuar me vulë apostule ose nga Ambasada Shqiptare në vendin e huaj ose nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

5) Komisioni pasi shqyrton dosjen merr vendim për njohjen e certifikatës profesionale ndërkombëtare ose mund të vendosë t’ia kthejë dosjen aplikantit për plotësime të nevojshme, brenda 20 ditëve pune nga vendosja në dispozicion e dosjes së aplikantit.

12.1 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë në vijim të konstatimeve të trajtuara dhe të dokumentacioneve, të vendosë mbi vlefshmërinë e vendimit të Komisionit të KKAB si dhe të analizojë veprimet dhe mosveprimet e funksionarëve të shtetit në ushtrimin e detyrave funksionale në përputhje me Kodin e Etikës.

Menjëherë

B.2. Gjetje dhe Rekomandime (12) për Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (DH/MFK)

(Trajtuar më hollësisht në Aneksin nr. 2, pjesë e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi)

1.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2019, DH/MFK ka kryer rishikimin e pyetësorit të vetëvlerësimit duke përpiluar pyetësorë të dedikuar për njësitë publike dhe gjithashtu për institucionet e varësisë. Rishikimi i pyetësorit është diskutuar edhe në mbledhjen nr. 3 të Bordit të KBFP zhvilluar në datë 27.12.2018, ku në përfundim të saj është rënë dakord për rishikimin e metodologjisë së monitorimit të performances dhe dërgimin e pyetësorëve të rinj të MFK në njësitë publike. Miratimi zyrtar i pyetësorit të vetëvlerësimit KBFP është kryer vetëm me miratimin e metodologjisë së rishikuar të monitorimit të performancës, përkatësisht sipas urdhrin nr. 117, datë 01.04.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Pavarësisht kësaj, DH/MFK ka kryer njoftimin e njësive publike përgjatë muajit janar-shkurt mbi përmbajtjen e këtij pyetësori duke kërkuar dorëzimin e tij pranë nëpunësit të pare autorizues sipas ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Drejtoria e Harmonizimit ka kryer trajnim të njësive publike gjatë periudhës 6 Shkurt-21 Shkurt 2019, periudhë kjo që rezulton të jetë relativisht e vonë, dhe qëpërkon me përgatitjen e raportit për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm (në fund të muajit Shkurt duhet të dorëzohen pranë DH/KBFP). Gjithashtu, konstatohet se raportimi për efekt të treguesve të kontrollit të brendshëm financiar publik është bazuar në të dhënat e dorëzuara nga njësitë publike pikërisht në të njëjtën periudhë në të cilën është kryer dhe trajnimi i tyre për pyetësorët e ndryshuar. Ndryshimi i pyetësorit nuk është shoqëruar me rishikim të manualit të MFK miratuar me urdhrin nr. 108 datë 17.11.2016, me qëllim përshtatjen e tij me ndryshimet në mënyrën e vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

1.1 Rekomandimi:Strukturat Drejtuese të DH/MFK të marrin masat për rishikimin e manualit të MFK në përputhje me ndryshimet e pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm me qëllim përfshirjen e udhëzimeve sqaruese për mënyrën se si do të raportohet nga njësitë dhe si do të kryhet vlerësimi nga DH/MFK, me qëllim raportimin e një situate sa më reale mbi sistemet e kontrollit të brendshëm si nga ana e institucioneve publike, ashtu edhe nga vlerësimi që kryhen drejtoria.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi:Pas dërgimit të pyetësorit të vetëvlerësimit nga njësitë publike pranë DH/MFK nuk rezulton të jetë kryer një konsolidim i rezultateve për çdo njësi që ka raportuar pranë Drejtorisë në mënyrë që të kryhet vlerësim specifik për njësinë, objektiv ky që ishte edhe kryesori për rishikimin e pyetësorit të vetëvlerësimit. Konvertimi në pikë në bazë të evidencave dhe përgjigjeve të dhëna në pyetësor janë dhënë vetëm në kuadër të monitorimit të performancës së njësive, sipas indikatorëve të MFK, të cilët përfaqësojnë vetëm 30 pyetje të pyetësorit të vetëvlerësimit nga 99 që përmbante në total pyetësori, ose 69 më pak.

Në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm sipas 5 komponentëve të MFK në bazë të vetëvlerësimit të njësive publike , sipas 17 parimeve të konvertuara nga 99 pyetje në pyetësorin e rishikuar, situata e raportuar nga DH/KBFP është tejte e përgjithshme, dhe nuk janë kryer analiza specifike, raportime në formë grafiku sipas grupit të institucioneve për vlerësimin e rezultateve në krahasim me vitet e mëparshme, por vetëm janë renditur disa nga problematikat kryesore, të cilat nuk janë shoqëruar me numër rastesh, apo subjektet në të cilat janë vërejtur fenomenet e raportuara.

Mungesa e analizave të detajuara në shkallë subjekti apo grupi për të cilën është kryer analiza sipas 5 komponentëve të MFK, nuk jep siguri se problematikat kryesore të identifikuar nga Drejtoria e Harmonizimit në raport janë gjithëpërfshirëse, në kushtet kur nuk raportohen rastet e identifikuar të mungesave, përhapja ose jo e tyre, etj.

2.1 Rekomandimi: DH/MFK të marrë masat për kryerjen e një vlerësimi bazuar në të dhënat totale të dorëzuara nga njësi publike sipas kërkesave të pyetësorit të rishikuar, me qëllim identifikimin e mangësive për çdo njësi publike që ka kryer dorëzimin e këtij dokumenti pranë kësaj drejtorie.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Raportin Vjetor për vitin 2018 mbi funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, janë raportuar në total 5 monitorime të kryera gjatë periudhës Prill-Maj të vitin 2019, krahasuar me 20 monitorime të kryera një vit më parë. Në dispozicion të grupit të auditimit u vendosën edhe shkresa të tjera për njoftimin e institucioneve për kryerjen e vizitave monitoruese, që përcaktojnë kryerjen e këtyre monitorimeve në muajin maj-qershor; por rezultatet e se cilave nuk janë bërë pjesë e Raportit Vjetor të KBFP për vitin 2018. Duke mos zbatuar kërkesat e manualit të MFK i cili udhëzon “*Llogaritjen e numrit të njërive publike që do të monitorohen nga çdo punonjës i DH/MFK duke ndarë ditët e punës në dispozicion për një vit të caktuar që DH/MFK ka planifikuar të shpenzojë për vizitat në terren, si dhe duke u nisur nga kohëzgjatja e një vizite në terren.*”, dhe sipas përqindjes: 50% njësi publike nga grupi “i performuesve të dobët”, 25% nga “performuesit mesatar, 25% nga “performuesit e mire” DH/MFK nuk rezultojnë të ketë kryer dhe dokumentuar një analizë e tillë për përzgjedhjen e njërive që janë monitoruar.

Monitorimi i raportuar në Raportin Vjetor të KBFP për vitin 2018 është kryer vetëm në dy institucione të pavarura (nga të cilat një institucion nuk funksionon që nga fundi i vitit 2018), një ministri, dy bashki, duke mos bërë pjesë së përzgjedhjes njësitë shpenzuese me buxhet të madh dhe institucionet e grupit 87 në varësi të Kryeministrisë, të cilat janë pjesë e raportit vjetor të KBFP.

a. Nga auditimi u konstatua se në zbatim të manualit të Menaxhimit Financiar i cili citon “*Në përfundim të vizitës në terren punonjësi i DH/MFK kryen një vlerësim të përgjithshëm mbi besueshmërinë e procesit të vetë vlerësimit të njësisë publike: 100-75%- Vetëvlerësim i besueshëm dhe 74%-0%- Vetëvlerësim jo i besueshëm, i cili përfshihet në raportin vjetor të KBFP*”, në konkluzionet e raportuara për vizitat në terren, nga 5 subjektet e përzgjedhura për monitorim rezultojnë se 3 prej pyetësorëve janë të besueshme, ku përkatësisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është vlerësuar me një vetëvlerësim jo të besueshëm (70% niveli i besueshmërisë) dhe në Bashkinë Devoll nuk është përcaktuar një përqindje e besueshmërisë por është evidentuar nga DH/MFK nevoja për asistencë për plotësimin e këtij pyetësori nëpërmjet kërkesave ligjore në fusha të ndryshme.

Gjithashtu, vizitat në terren nuk janë shoqëruar me letrat e punës dhe dokumentime të tjera, në kundërshtim me aneksin 9 “Metodologjia dhe lista e kontrollit për vizitat në terren”, pika 3.

Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me pikën 2.2.2 të Manualit të Menaxhimit Financiar, monitorimet e njërive publike nga DH/MFK kryen në një periudhë shumë të reduktuar kohore (prill-maj 2019) periudhë kjo që përkon me konsolidimin e rezultateve dhe paraqitjen e tyre në Raportin Vjetor të KBFP, dhe për këtë arsye nga 10 shkresa për monitorim që janë dërguar pjesë e raportit janë bërë vetëm 5 prej tyre.

Lidhur me rolin e DH/MFK si monitoruese e vazhdueshme e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucionet publike, në raportin vjetor janë cituar 20 monitorimet e kryera gjatë një viti më parë, të cilat kanë qenë pjesë e Raportit Vjetor të KBFP për vitin 2017, duke mos identifikuar monitorime të tjera të vazhdueshme pas publikimit të raportit vjetor të KBFP, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, i cili është një nga detyrimet kryesore të kësaj drejtorie, cituar në manual.

b.Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me manualin e MFK i cili citon se: “*Në përfundim të vizitës në terren, hartimin nga punonjësit e DH/MFK të raportit për njësinë publike përkatëse, në të cilin krahas vlerësimit do të specifikohen edhe rekomandime konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të MFK. Ky raport i dërgohet zyrtarisht njësisë publike, e cila përgatit planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, të miratuar nga NA e njësisë publike. Një përmbledhëse e raporteve të vizitave në terren, bëhet pjesë e raportit vjetor të KBFP, në një kapitull të veçantë*”, DH/MFK pas përfundimit të monitorimeve në terren ka kryer një analizë të përgjithshme mbi nivelin e besueshmërisë së pyetësorëve, por pa përcaktuar gjetje dhe diferenca konkrete të identifikuar gjatë këtyre vizitave.

Problematika e identifikuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH vijon të mbetet e parishikuar nga DH/MFK, ku monitorimet e vitit 2019 janë bërë pjesë e raportit vjetor të publikuar në muajin Maj 2018, dhe gjetjet kryesore dhe rekomandimet përkatëse ende nuk janë vendosur në dispozicion të njësisë të përzgjedhura.

c.Nga auditimi u konstatua se manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit udhëzon se ndjekja e rekomandimeve do të kryhet në monitorimin e ardhshëm të institucioneve, por referuar numrit të monitorimeve të kryera gjatë një viti, si dhe metodologjisë sipas së cilës kjo përzgjedhje kryhet, ndjekja e rekomandimeve do të mund të realizohet disa vite me vonë, ku referuar numrit më të reduktuar të monitorimeve të kryera gjatë vitit 2019, ndjekja e rekomandimeve do të kryhet pas 28 vitesh, krahasuar me 5 vite që ishte përlllogaritur një vit më parë në bazë të numrit të njësisë publike që kanë raportuar pranë DH/MFK dhe numrit të monitorimeve të kryera.(143 njësi publike që kanë dorëzuar pyetësorë/ 5 monitorime gjatë vitit = 28 vjet. Pra ndjekja e rekomandimeve do të kryhet pas më shumë se 28 vitesh).

3.1 Rekomandimi:Strukturat drejtuese të DH/KBFP të marrin masa të menjëhershme për rishikim të procedurave të ndjekura për kryerjen e vlerësimit në vend të njësisë publike për elementët e kontrollit të brendshëm financiar publik, duke rritur numrin e vizitave, si dhe duke përmirësuar praktikën e punës të ndjekur për raportimin e rezultateve, dhe ndjekjen e rekomandimeve me qëllim ndërmarrjen e iniciativave konkrete për monitorimin e sistemeve të KBFP.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi:Referuar detyrimit të Drejtorisë së Harmonizimit për kryerjen e konsolidimit të raporteve dhe pyetësorëve të vetëvlerësimit të njësisë publike, sipas nenit 26, pika 3 i cili citon se “*Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe për përgatitjen e raportit vjetor përgjendjen menaxhimit financiar dhe kontrollit publik, ku përmbledhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.*”, u krye analizimi i të dhënave të raportuara në Raportin Vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2018. Nga auditimi konstatohet se në dallim nga vitet e mëparshme, ky raport kishte mungesa të konsiderueshme në raportimin e situatës reale lidhur me vetëvlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për shkak të mos kryerjes së analizimeve në shifra/vlera të rezultateve të gjeneruara nga pyetësorët. Pas kryerjes së ndryshimit të pyetësorit të vetëvlerësimit, Drejtorja e

Harmonizimit kryen konvertimin në pikë për çdo pyetje të këtij dokumenti, në bazë të përgjigjes së institucionit, ku ky i fundit paraqet dokumentacione të ndryshme për të suportuar informacionin e deklaruar.

Në raportin vjetor të KBFP, Drejtoria e Harmonizimit është shprehur se “Në bazë të analizës së vetëvlerësimit si dhe të monitorimeve të vazhdueshme të stafit të DH/MFKK-së, sistemet e kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme vlerësohen pjesërisht efektiv, bazuar në 17 parimet e modelit COSO”.

Gjithashtu, është vlerësuar se “Nga analiza e 143 pyetësorëve, rezulton se efektiviteti është në masën 72% (ky tregues është përcaktuar nga mesatarja e efektivitetit të treguesit të performancës për MFKK “Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemet e kontrollit të brendshëm “ për ministrinë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, Grupit 87 të Kryeministrisë dhe njësitë shpenzuese me buxhet të madh)”.

Për vlerësimin e efektivitetit në përqindje të sistemeve të kontrollit të brendshëm, përveç komentit si pjesërisht efektiv, DH/KBFP ka marrë në konsideratë **vetëm një** nga indikatorët e vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, **i cili nuk vlerësohet nga pyetjet e pyetësorit** (vlerësimi nga 1-4 do bëhet 1 pikë mbi afatin kohor të dorëzimit të dokumentacionit, 1 pikë për deklaratën dhe raportin dhe 2 pikë mbi gjithëpërfshirjen dhe rregullsinë e informacionit të paraqitur në pyetësorin e vetëvlerësimit), dhe % e realizimit është 72% ose 2.85/4. Nëse i referohemi indikatorëve të performancës, ky tregues i përdorur për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, është faktikisht treguesi i vlerësuar më lartë në krahasim me dy indikatorët e tjerë të MFK, pasi nëse analizojmë mesataren e efektivitetit për të tre treguesit e performancës së MFK, të cilët rezultojnë nga analizimi i 39 pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit⁵, **efektiviteti vlerësohet 67%**, ose 2.71/4, ku “Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm është vlerësuar me 2.9 pikë nga 4 të mundshme (73%), Hartimi me cilësi i planit të veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara është vlerësuar mesatarisht 2.53 pikë nga 4 pikë të mundshme (63.2%), dhe Efektiviteti i mekanizmave baze të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik është vlerësuar me 2.7 pikë nga 4 pikë të mundshme (67.6%). Në krahasim me vitin 2017, në të cilën vlerësimi ishte kryer mbi 129 institucione niveli i efektivitetit ishte në masën 85%, ose 3.41/4; dhe në vitin 2016 ishte vlerësuar në masën 79% ose 3.16/4.

4.1 Rekomandimi: Në vijim edhe të rekomandimeve të mëparshme të KLSH, DH/KBFP të marrë masat për raportimin e plotë të sistemeve të KBFP duke përfshirë edhe njësitë e varësisë, nëpërmjet konsolidimit të të dhënave të tyre nga njësitë publike që raportojnë pranë kësaj

4.2 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të DH/KBFP, në vijim edhe të kërkesave të indikatorëve të Strategjisë PFM, për vlerësimin e përqindjes së efektivitetit të kontroleve të brendshme, të marrin masat për kryerjen e një përllogaritjeje të plotë dhe gjithëpërfshirëse për raportimin e saktë të efektivitetit të sistemit të kontrollit financiar publik, në mënyrë që të ndiqet në mënyrë krahasimore kjo analizë me vitet e mëparshme dhe të garantohet forcimi i sistemeve, reflektuar në rritjen e nivelit të efektivitetit. Nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë të vlerësohet situata e mësipërme dhe të nxirren përgjegjësitë për raportim jo të drejtë referuar situatës së efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

drejtorie. Bordi i KBFP të analizojë problematikën e ngritur në vijimësi nga KLSH dhe të marrë masat e nevojshme për funksionimin e DH/KBFP në përmbushje të misionit monitorues dhe raportues të këtyre sistemeve.

⁵Në mënyrë analoge me raportin e një viti më parë ku është cituar se : Efektiviteti i përgjithshëm i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit llogaritës mesatarë pikëvetëpyetësorit të vetëvlerësimit për të gjitha njësitë publike të marranë analizë, dhe në kushtet kur vlerësimi në pikë nga DH është bërë vetëm për efekt të përzgjedhura për indikatorë.

4.3 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Bordin e KBFP të marrë masat për kryerjen e shqyrtimit dhe miratimit të raportit vjetor të KBFP në zbatim të afateve të përcaktuara në ligj, me qëllim vlerësimin në kohë të mënyrës së trajtimit të problematikave të identifikuara në sistemet e kontrollit të brendshëm nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit, përpara publikimit të këtij raporti në faqen zyrtare.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kuadër të planifikimit të aktiviteteve sipas shtyllës 5 të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Drejtoria e Harmonizimit gjatë vitit 2016 kishte planifikuar kryerjen e procesit të pilotimit për implementimin e MFK për 2 ministri linje, 2 bashki si dhe 2 institucione të pavarura bazuar në përvojën e fituar nga projekti i mëparshëm, dhe në 2017 planifikimi fillestar ka përzgjedhur për pilotim (MPB, MTI, Bashkia Vlorë, Bashkia Gjirokastrë, Autoriteti i Konkurrencës dhe Avokati i Popullit) dhe në planin e rishikuarnumri i njësive të përzgjedhura është reduktuar në 4 institucione: Autoritetit Rrugor, Ministrinë e Brendshme, Avokati i Popullit dhe Autoriteti i konkurrencës, por për shkak të ndryshimeve rishikuese ky proces nuk mundi të konkludonte asnjë nga aktivitetet e planifikuara. **Gjatë vitit 2018, evidentohet se procesi i pilotimit ka konkluduar vetëm për dy institucione**, konkretisht për Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Bashkinë Vlorë, pasi për dy institucionet e tjera është theksuar se problematikanë ndryshimet e shpeshta strukturore është bërë shkak për ndërprerjen e aktiviteteve përkatësisht në Ministrinë e Brendshme dhe atë të Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo situatë evidenton se nga 6 implementime pilot të planifikuara për shtrirjen e një sistemi modern në institucionet shtetërore, pas përfitimit të eksperiencës nga Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e cila është asistuar për një periudhë dy vjeçare (Shtator 2014-Nëntor 2016) nga projekti i binjakëzimit: "Implementimi i një Sistemi Modern për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Inspektimin Financiar Publik në Shqipëri", i financuar nga fondet IPA 2012, zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Austrisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Francës, në harkun 2 vjeçar janë realizuar pjesërisht vetëm 2 prej tyre nga 6 të planifikuara.

Sipas planit vjetor të DH/MFK në lidhje me zbatimin e sistemit modern të MFK në 4 institucione pilot, është përcaktuar si objektiv ngritja e një sistemi të shëndoshë të MFK-së për këto institucione nëpërmjet përgatitjes së instrumentave që shërbejnë në implementimin e MFK: rregullore, procedura të brendshme, regjistri i risqeve, manualët e punës, harta e proceseve dhe gjurmëve të auditimit.

Nga auditimi u konstatua se procesi i kryerjes së monitorimeve pilot nuk rezulton i rregulluar sipas një metodologjie të caktuar, dhe si rezultat nuk janë përgatitur letra pune për dokumentim të aktiviteteve të kryera. Më hollësisht, faza paraprake e vlerësimit të cilësisë së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, e cila shërben për identifikimin e nevojave për përmirësim të këtij sistemi, nuk është shoqëruar me një raport konkret. Si rezultat, aktivitetet e planifikuara për tu realizuara, kanë qenë të njëjta për të gjithë institucionet e përzgjedhura për monitorim pilot, pavarësisht ndryshimeve në nivelin në të cilën kanë qenë këto institucione, e reflektuar kjo në renditjen e tyre në raportin vjetor të KBFP për vitin 2017.

Aktivitetet e planifikuara kanë qenë të shoqëruara me afate kohore precize dhe kanë konsistuar në përgatitjen e planeve të punës, manualeve të proceseve të punës, regjistri i riskut, plan veprimi për minimizimin e riskut, gjurmët e auditimit, përgatitja e planit të zhvillimit të MFK, por në përfundim të 2 monitorimeve që janë raportuar nga drejtoria si të përfunduara me sukses, nuk disponohen dokumentacionet e hartuara nga njësia e përzgjedhur për monitorim, duke mos garantuar efektivitetin e këtij procesi. Gjithashtu, vlerësimi i këtyre njësive në Raportin Vjetor të KBFP, nuk reflekton një përmirësim të gjendjes së sistemeve respektive, në kushtet kur

institucionet e raportuara si të papërfunduara të monitorimit pilot rezultojnë në renditje në nivele të larta, dhe institucionet e tjera për të cilat monitorimi ka konkluduar me sukses kanë patur një rënie/ nuk kanë ndryshuar në renditjen e përgjithshme.

5.1 Rekomandimi:Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për kryerjen në mënyrë sa më efektive të planifikimit dhe implementimit të sistemeve të MFK në institucionet pilot, në mënyrë që të realizohen pritshmëritë e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike në fushën e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik, duke kryer shoqërimin e këtyre vizitave me letrat e punës që dokumentojnë arritjen e objektivave të paracaktuar, për forcimin e sistemeve të MFK në njësitë respektive.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi:Pas rishikimit të pyetësorit të vetëvlerësimit, nga ana e DH/MFK është përcaktuar se njësitë publike do të kryenin vetëvlerësimin, tanimë jo me pikë por duke referuar dokumentacionet përkatëse për secilën nga 99 pyetjet e pyetësorit, dhe Drejtorja e Harmonizimit do të përpunonte të dhënat dhe do të kryente vlerësimin në pikë. Nga auditimi konstatohet se DH/MFK ka kryer vlerësimin në pikë vetëm për efekt të indikatorëve, duke mos kryer konvertim të përgjigjeve në pikë respektive për pyetjet e pyetësorit që nuk janë përfshirë në metodologjinë e indikatorëve të MFK. Gjithashtu, konstatohet se vlerësimi në pikë për pyetësorët nuk është kryer në mënyrë të drejtë në analogji me përgjigjet e dhëna nga institucionet raportuese, konstatim ky i mbështetur në rezultatet e trajtuara në Aneksin nr.2 të Projektraportit të auditimit, ku më hollësisht për të njëjtën përgjigje të dhënë nga institucioni, vlerësimi i kryer nga Drejtorja e Harmonizimit ka qenë i ndryshëm, duke mos raportuar në mënyrë të drejtë situatën e sistemeve të KBFP në njësi publike.

Nga auditimi konstatohet se me ndryshimin e metodologjisë së performancës, në indikatorët e Auditit të Brendshëm nuk është përfshirë vlerësimi i pyetësorëve të vetëvlerësimit të situatës së auditit të brendshëm (total 40 pyetje). Si rezultat, edhe pse njësitë publike sipas detyrimit të tyre dorëzojnë pranë DH/AB pyetësorët e vetëvlerësimit të auditit të brendshëm, këto pyetësorë nuk bëhen pjesë e vlerësimit në total të situatës së auditit të brendshëm në sektorin publik nëpërmjet indikatorëve të performancës.

Në lidhje me indikatorin “*Njësia publike realizon shërbimin e AB*”, konstatohet se nga 19 njësi publike që rezultojnë të kenë realizuar shërbimin e AB me marrëveshje, vetëm Bashkia Pustec është listuar në njësitë publike e vlerësuara për efekt të indikatorëve të performancës. Në lidhje me njësitë që nuk kanë mundur të realizojnë shërbimin e AB, ato nuk janë pjesë e vlerësimit për efekt të indikatorëve të AB, dhe si rezultat për të gjitha njësitë e marra në vlerësim, vlerësimi në pikë për këtë indikator është maksimal (1 pikë). Gjithashtu, edhe për vlerësimin në pikë të njësisve, u identifikuan raste në të cilat njësitë nuk kanë plotësuar detyrimin ligjor për numrin e audituesve, drejtuesi e AB, certifikimin e audituesve, etj dhe rezultojnë të vlerësuara me pikët maksimale.

6.1 Rekomandimi:DH/KBFP të marrë masat për kryerjen e vlerësimit në pikë në bazë të përgjigjeve reale të dhëna nga institucionet raportuese pranë drejtorisë, sipas udhëzimit për kryerjen e këtij vlerësimi në pikë nga DH/AB dhe DH/MFK, me qëllim raportimin e saktë të situatës sipas përgjigjeve të institucioneve.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Në kuadrin e krijimit të një sistemi efektiv në fushën e raportimit financiar dhe kontabilitetit në sektorin publik si dhe në përputhje me Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, DH/MFK ka parashikuar për vitin 2019 hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik të Veprimit në fushën e kontabilitetit të sektorit publik, në bashkëpunim me konsulentin ndërkombëtar të projektit. Ky plan do të përfshijë:

Planin e implementimit të projektit; Përgatitjen e termave të referencës dhe specifikimet teknike për komponentët e tjerë të projektit; Programet e trajnimit, në kuadër të rritjes së kapaciteteve të punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe stafit përgjegjës për financat në të gjitha njësitë publike; Kontrollin e cilësisë të produkteve të projektit; Zhvillimin e një strategjie komunikimi dhe strategjie mbi menaxhimin e ndryshimeve.

Gjatë periudhës objekt auditimi nuk janë identifikuar iniciativa konkrete për përgatitjen e këtij plani nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit. Ndërmarrja e angazhimeve për përgatitjen e këtij plani, 1 vit përpara afatit përfundimtar për përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve, konsiderohet një iniciativë e vonuar e drejtorisë, si udhëheqëse e metodologjisë në sektorin e kontabilitetit. Në raportin vjetor të KBFP, veprimtaria e kësaj drejtorie është përqendruar në përgatitjen e një udhëzimi, i cili për shkak se është kryer në pjesën e parë të vitit 2018, ka qenë pjesë e raportimit të veprimtarisë së Drejtorisë edhe për vitin paraardhës.

Menjëherë

7.1 Rekomandimi:DH/MFK në vijim edhe të konstatimeve të mëparshme të KLSH, të marrë masat për ndërmarrjen e iniciativave konkrete për implementimin e objektivave të strategjisë së PFM me objektiv kryesor përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit publik

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi konstatohet se në vijim të rekomandimeve të lëna nga KE për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, gjatë vitit 2018 ende nuk janë ndërmarrë masat për përgatitjen e një politike të qartë për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe mënyrës se si kjo mund të aplikohet në sektorin publik. Delegimi i detyrave mbetet ende një problematikë e pa rregulluar nga njësitë publike.Gjithashtu, monitorimi i kryer nga Drejtoria e Harmonizimit, në krahasim me vitin që kaloi ka rezultuar në rënie, e shoqëruar kjo me vlerësimin e kryer për njësitë publike vetëm për një pjesë të pyetjeve të pyetësorëve të vetëvlerësimit, ku ashtu sikundër është trajtuar edhe më sipër, ky vlerësim paraqet pasaktësi.

Menjëherë

8.1 Rekomandimi:Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të ndërmarrë iniciativa konkrete për përmbushjen e rekomandimeve të lëna në raport progresin e KE, të tilla si politika e qartë për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale, dhe delegimi i detyrave nga njësitë publike, shoqëruar me forcimin e rolit të saj si monitoruese të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi:Referuar raportimit të udhëzimit nr. 8, të Ministrisë Financave si pjesë e analizes vjetore të DH/MFK për vitin 2018, pavarësisht trajtimit të kësaj çështjeje edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH, për shkak të mungesës së iniciativave nga ana e DH.MFK për shqyrtimin e rekomandimit, kjo gjetje ri sillet në vëmendje të strukturave drejtuese të MFE. Ky udhëzim është finalizuar, miratuar dhe publikuar si Udhëzimi nr. 8 dt. 9.3.2018. Për përpilimin e këtij Udhëzimi është ngritur grupi i punës me Urdhrin nr. 142 dt. 17.11.2017 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e bazës rregullatore të kontabilitetit publik për një periudhë tranzitore, deri në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (IPSAS)”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion: dosje e çështjeve të ndjekura në lidhje me kontabilitetin dhe përmirësimet e tjera ligjore; nuk rezulton të jetë e plotësuar me minutat

mblledhjeve të grupeve të punës apo relacione “dhënie mendim” apo versione finale të miratuara të udhëzimeve të përpiluara apo të analizës të sipër përmendur.

Në kushtet kur prej disa vitesh është shtruar çështja se sistemit publik shqiptar i mungojnë standardet e kontabilitet të miratuara, nuk disponojmë nga DH/MFK ndonjë mbledhje të dedikuar të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, për propozimin e hartimit të një dokumenti të tillë tranzitor, duke përcaktuar çfarë konkretisht rregullon ai, çfarë ndryshimesh sjell? Pika 2 thotë “rivënie në zbatim të rregullave në fushën e kontabiliteti publik? A kanë qenë të përpiluara dhe të detyrueshme për zbatim më parë këto rregulla dhe kur pushuan së zbatuari? Cila është përcaktuar si periudhë tranzitore; Cilat IPSA janë përshtatur/adaptuar?

Në këtë Udhëzim, pika 8 thuhet se “ Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me: • njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; si dhe • njohjen e të ardhurave në çastin e arkëtimit të tyre. Pra kemi të bëjmë me një “cash basis” të modifikuar. Nëse ky udhëzim sjell ndryshime në njohjen trajtimin dhe mënyrën e kontabilizimit të transaksioneve të caktuara atëherë Udhëzimit i duhet të plotësoj me parashikim të një periudhë tranzicioni si çdo praktikë ndërkombëtare e Bordeve rregulluese dhe mbikëqyrëse që nxjerr një standard apo letër pune shpjeguese për të shmangur konfuzion në interpretim dhe për një paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme brenda një viti ushtrimor.

Gjithashtu, në Udhëzimin nr. 23 dt. 22.12.2017 pika 30, konfirmohet se baza ligjore, rregullatore për përgatitjen e pasqyrave financiare është Udhëzimi nr. 14 dt. 2006, i rishikuar 2007, 2008, i Ministrisë të Financave mbi përgatitjen dhe publikimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe njësitë e zbatimit të projekteve për marrëveshjet me donatorët e huaj. Nga shqyrtimi i ndryshimeve të vitit 2007 dhe 2008 në Udhëzimin nr. 14 dt. 28.12.2006, konstatoam se ndryshimet e vitit 2008 shfuqizuan pikat 8 dhe 9 e rubrikës I-rë, përkatësisht:

8. *Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave, mbi bazën e informacionit të depozituar, harton brenda datës 15 Qershor 2007 përmbledhëset e llogarive vjetore 2006 në këto nivele; Për Ministrinë dhe Institucionet e tjera qendrore ; Për ISSH dhe ISKSH Për njësitë e menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj; Për organet e Qeverisjes Vendore,*

9. *Drejtoria e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave mbi bazën e të gjithë informacionit të hartuar e depozituar **bën konsolidimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 në nivel qendror e lokal dhe i raporton ato brenda datës 15 Korrik 2007.***

Pra Udhëzimi nr.14 i dt. 28.12.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr. 10 dt. 27.2.2008 nuk parashikon një pikë se kush bën konsolidimin e pasqyrave financiar duke mbetur përsëri me Udhëzimet e përvitshme për mbyllje të llogarive të buxhetit nga Thesari.

Një tjetër sqarim që duhet të parashikonte DH/MFK është raporti/lidhja midis Udhëzimi nr. 14 i 2006-s dhe Udhëzimi nr. 8 i 2018-s. A janë ata plotësues të njëri tjetrit apo ai më i hershmi shfuqizohet.

Në lidhje me parimi i njohjes dhe regjistrimit të shpenzimit.

Udhëzimi nr. 23 dt. 22.12.2017, pika 1.b: Në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen: Të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të regjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2017, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave (accrual basis).

Në udhëzimin e përvitshëm të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.39 datë 24.12.2018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2018” pjesa V “Rakordimi

dhe mbyllja e llogarive vjetore të qeverisjes së përgjithshme”, pika 33 e tij parashikon se: “Rakordimi, mbyllja e llogarive të tjera vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe hartimi i pasqyrave financiare do të kryhet në bazë të udhëzimit MFE nr. 8, datë 09.03.2018”.

Udhëzimi i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 37 parashikon: “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë cash (cash basis), me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët”. Si dhe në pikën 42, ku parashikohet se: “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara (commitment), për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në varësi të natyrës së tyre”.

Sikurse është konstatuar nga KLSH në auditimin e vitit të kaluar, kjo pikë e Udhëzimit Ministrisë Financave nr.8, datë 09.03.2018, është në kundërshtim me nenin 61, shkronja (a) e ligjit nr.9939, datë 26.06.2008 i ndryshuar “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se : shpenzimi njihet në momentin e ndodhjes pra jo të pagesës. Fakti që nuk ka fonde disponibël për pagesë, nuk është arsye që këto shpenzime të njihen si shpenzime të periudhave të ardhshme pasi ato në të vërtetë kanë ndodhur, në këtë mënyrë denatyrohet raportimi i shpenzimeve për investime, krijohen hapësira për marjen e angazhimeve pa patur fonde buxhetore disponibël, rrjedhimisht kjo çon në rritjen e detyrimeve të prapambetura (stokut).

Menjëherë

9.1 Rekomandimi:DH/MFK të rishikojë menjëherë Udhëzimin e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, me qëllim harmonizimin e tij me ligjin për menaxhimin e buxhetit dhe Udhëzime të tjera në fushën e kontabilitetit.

Menjëherë

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pas ndryshimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 në atë nr. 110/2015, datë 15.10.2015, konkretisht neni 18 i tij, pika 1, janë përjashtuar nga përgjegjësia për përgatitjen së pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe raportit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe dorëzimin tyre tek nëpunësi i parë autorizues, njësitë publike të përfshira në pikën 2, të nenit 3: Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.

Referuar fushës së zbatimit të ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për përgatitjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i cilipërfshin: njësitë e qeverisjes së përgjithshme; shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme; njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare; raportimi pranë Nëpunësit të Parë Autorizues dhe DH/MFK, kufizohet vetëm tek njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në ndryshim me ligjin e auditimit të brendshëm ku

fusha e zbatimit dhe raportimi pranë DH/AB është e njëjtë.

Si rezultat, raportimi i DH/MFK për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, kryhet nga analizimi i të dhënave për **143 njësi** publike (njësitë e mëdha të qeverisjes së përgjithshme), nga një total prej mbi **1200 institucione**sh që rezultojnë nga të dhënat e buxhetit. Referuar problematikave të konstatuara më sipër në këtë material, për garantimin e kryerjes së konsolidimit të të dhënave të institucioneve të varësisë në pyetësorët dhe raportet e njësisë qendrore, numri i njësive që monitorohen dhe raportohen nga DH/KBFP bëhet edhe më i vogël, dhe si rezultat më pak gjithëpërfshirës. Kështu, referuar rëndësisë së njëjtë të këtyre dy drejtorive, si pjesë të DH/KBFP, dhe raportimin mbi situatën e Kontrollit të Brendshëm, sigurimi i një informacioni thelbësor, edhe pse jo të hollësishëm nga një numër më i gjerë i institucioneve përgjegjëse për krijimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në raportimin vjetor të KBFP garanton dhe jep një pamje më të plotë, të saktë dhe gjithëpërfshirëse të këtij dokumenti .

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si institucion përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, të marrë masat për përgatitjen dhe shpërndarjen e pyetësorëve të veçantë dhe të personalizuar sipas grupeve, për institucionet e varësisë, shoqëritë tregtare, OJF, autoritetet e përbashkëta apo institucione të tjera të financuara nga buxheti i shtetit apo që kanë në përdorim asete shtetërore, në mënyrë që këto institucione, si njësi të sektorit publik përgjegjëse për zbatimin e ligjit të MFK, të bëhen pjesë e raportit të KBFP dhe të monitorohen nga DH/MFK për funksionimin sa më të mirë dhe efikas të sistemeve të tyre në zbatim të manualit dhe ligjit të MFK.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se referuar periudhës objekt auditimi, në strukturën faktike të në Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik ekzistojnë vende të paplotësuara përkatësisht për 2 përgjegjës sektori. Detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie janë përcaktuar në ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, manualin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe rregullore të tjera që udhëzojnë veprimtarinë për çështje specifike të DH/MFK .

Menjëherë

12.1. Rekomandimi: Për përmbushjen e misionit dhe detyrave funksionale të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi në lidhje me auditimin e brendshëm publik dhe menaxhimt financiar dhe kontrollit, nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, sipas legjislacionit në fuqi, të bëjë të mundur shpalljen dhe plotësimin e vendeve vakant në Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik .

Menjëherë

C.Mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm.

(Trajtuar më hollësisht në Aneksin nr. 4, pjesë e Raporti Përfundimtar Auditimi)

1.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguaranë Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, paraqitet si më poshtë:

- a) Janë rekomanduar **2 propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, të cilat nuk janë pranuar.**
- b) Janë rekomanduar **25 masa organizative**, nga të cilat 12 rekomandime **nuk janë pranuar, 1 masë është pranuar pjesërisht dhe janë pranuar 12 masa**, nga të cilat janë në proces zbatimi 4 masa organizative, 1 masë e zbatuar pjesërisht dhe 7 masa janë zbatuar.
- c) **Është rekomanduar 1 masë disiplinore**, e cila nuk është pranuar.

12.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për ri zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën 301/8 prot., datë 07.08.2018, respektivisht: a) Për zbatimin e 2 propozimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, të cilat nuk janë pranuar. b) Për zbatimin e plotë edhe të 12 rekomandimeve për masa organizative të cilat nuk janë pranuar dhe 4 masa në proces zbatimi, të cilat më hollësisht janë trajtuar në aktverifikimin nr.01, datë 23.08.2019 (Për kryerjen e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, nga KLSH me shkresën nr. 301/8 prot., datë 07.08.2018, Projektraportin e auditimit dërguar me shkresën e KLSH nr. 389/2, datë 06.09.2019 Aneksi nr. 4 faqe 147-188).

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për mos zbatim jo të plotë të nenit 24-Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin public”, në zbatim të shkronjës (a), neni 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë** Ministrisë Financave dhe Ekonomisë që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **“Vërejtje” deri në “Largim nga detyra”, për 2 punonjësit e mëposhtëm:**

1.Znj.K. H., Drejtor i Përgjithshme i Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

2.z.D. F., Drejtori i Drejtorisë së Harmonizimit MFK, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,

Për mos zbatim jo të plotë të nenit 24-Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” **dhe konkretisht:**

-Nuk kanë administruar sa duhet veprimtarinë në fushën e auditimit të brendshëm duke mos bërë të mundur monitorimin e plotë të veprimtarisë auditues në nivel kombëtar (*shkronja, a*)

-Nuk kanë propozuar përmirësimin e legjislacionit kryesor dhe mbështetës për auditimin e brendshëm në sektorin publik, kryesisht për shoqëritë anonime (*shkronja, b*)

- Nuk kanë analizuar plotësisht rekomandimet e dhëna në raportet vjetore të njëjësive të auditimit të brendshëm (*shkronja, ë*)

- Për mos mbajtjen e saktë dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të audituesve të brendshëm (*shkronja, g*)

-Nuk kanë administruar procesin e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të veprimtarisë së njëjësive të auditimit të brendshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit të brendshëm (*shkronja dh*)

-Nga 24 rekomandime të KLSH në auditimin e fundit , kanë zbatuar vetëm 12 prej tyre, duke mos pranuar dhe zbatuar gjysmën e tyre.

-Nga KLSH janë rekomanduar 2 propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, ku rezultoi se ato nuk janë pranuar nga DH/KBFP dhe nuk i janë bërë prezent dhe për këto rekomandime nuk janë bërë propozime konkrete me shkrim Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë.

Shënimi i Kryetarit të KLSH-së:

E. Për Bordin e Mbikëqyrjes Publike.

Nisur nga problematikat që janë konstatuar gjatë auditimit të KLSH-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Bordit Mbikëqyrjes Publike, në të ardhmen Kontrolli i Lartë i Shtetit, do të ushtrojë një auditim tematik, mbi organizimin dhe funksionimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, në shkresën nr.304, prot, datë 01.10.2019, Drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë dhe për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit Ministrave, (drejtori ekzekutiv z. A. S.), ka përdorur një gjuhë jo etike në lidhje me projektraportin e auditimit dhe audituesve të KLSH-së.

Përgjatë muajit Tetor 2019, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Departamentit të Buxhetit të Shtetit dhe Drejtorja e Sigurimit të Cilësisë në KLSH, mund të sjellin propozime shtesë për përmirësimin këtij Vendimi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

KRYETAR